

## **Ivis Noçka**

Zj. Ivis Noçka ka lindur në Tiranë më 24.09.1972. Është diplomuar në Universitetin e Kalabrisë, Itali në vitin 1999 (Fakulteti i Ekonomisë) me titullin Doktor i Shkencave Ekonomike dhe ka marrë titullin Master për Menaxhimin e Biznesit, pranë INVENT, Gjermani.

Eksperienca në administratën publike e Zj.Noçka është disa vjeçare dhe prej vitit 2000 ka mbajtur pozicione të ndryshme në administratën publike si:

Këshilltare ekonomike në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtore Kabineti pranë Ministrit të Shtetit (KM), Drejtore e Integritimit Evropian në Ministrinë e Mbrojtjes, Përfaqësuese e lartë për sigurinë në Qendrën e Sigurisë Rajonale (RACVIAC), Zagreb Kroaci, Koodinatore pranë Zyrës së Menaxhimit të Sekretarit të Përgjithshëm, Kryeministria, Ministër Këshilltare pranë Misionit të Shqipërisë në OSBE, Vjenë etj., punë dhe misione.

Zj. Noçka ka qenë pedagoge për një periudhë 10 vjeçare në Universitetin Zoja e Këshillit të Mirë, në Fakultetin e Ekonomisë në fushën e drejtimit të sipërmarrjes. Zj. Noçka ka marrë pjesë dhe është certifikuar në trajnime të ndryshme të zhvilluara nga organizata ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2021 mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Zj.Noçka zotëron disa gjuhë të huaja si Anglisht, Italisht, Frëngjisht dhe Greqisht.